

LIGJ
Nr. 8322, datë 2.4.1998

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR EKSTRADIMIN
DHE TË DY PROTOKOLLEVE SHITESË**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa e Europiane e Ekstradimit të 13 dhjetorit 1957” dhe të dy protokolleve shtesë, përkatësisht të 15 tetorit 1957 dhe të 17 marsit 1978, me deklaratimet dhe rezervat që parashikohen në këtë ligj.

Neni 2

Lidhur me Konventën Shteti Shqiptar deklararon:

1. Lidhur me pikën 1 të nenit 2 të Konventës pala shqiptare nuk njeh kufij minimalë të masës të dënimit me burgim për efekt ekstradimi. Shteti shqiptar e njeh të vlefshëm këtë deklaram vetëm në kushte reciprociteti.

2. Lidhur me nenin 6, pika 1, shkronja “a”, pala shqiptare refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshje ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë.

3. Lidhur me nenin 6, pika 1, shkronja “b”, pala shqiptare me “shtetas” kupton edhe “personat me dyshtetësi”, kur përfshihet edhe shtetësia shqiptare.

4. Lidhur me nenin 7, pika 1, pala shqiptare nuk lejon ekstradimin e personave që kanë kryer vepra penale në territorin shqiptar ose edhe jashtë tij, kur vepra është kryer në dëm të interesave të shtetit ose shtetasve, përveç rastit kur arrihet marrëveshje e ndryshme me palën e interesuar.

5. Lidhur me pikën 2 të nenit 19 pala shqiptare deklararon se kur personi që kërkohet të ekstradohet është duke vuajtur dënim për një vepër tjetër, me rastin e ekstradimit, lejohet të vuajë plotësisht dënimin në vendin kërkues.

6. Lidhur me pikën 4, shkronja “a” të nenit 21 pala shqiptare deklararon se në rastet e tranzitit ajror që nuk parashikon ulje në territorin shqiptar, nuk është i nevojshëm njoftimi paraprak.

Deklarimet e pikave 1, 4 dhe 5 kanë vlerë vetëm në kushtet e reciprocitetit.

Neni 3

Lidhur me nenin 12, pika 2, Shteti Shqiptar paraqet rezervën se kërkesa për ekstradim kurdoherë duhet të shoqërohet me tekstin origjinal ose të vërtetuar të ligjit që zbatohet.

Neni 4

Për nënshkrimin e kësaj Konvente autorizohet ministri i Drejtësisë, i cili depoziton edhe instrumentet e ratifikimit.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2038, datë 9.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani